



EmpowerMed

Fuqizimi i grave për të vepruar ndaj varfërisë energjitike në Mesdhe.



Përmbajtja



Foto nga : GERES

- Çfarë është varfëria energjike?
- Pasojat e varfërisë energjike
- Fakte dhe shifra nga Evropa
- EmpowerMed: objektivat, aktivitetet & ndikimi i pritur
- Zonat pilote
- Faqja e Web-it dhe media sociale



Çfarë është varfëria energjitike?

- **Varfëria energjitike** është situata në të cilën një familje nuk mundet të kap minimumin e duhur të nivelit të konsumit të energjisë që të përballojë nevojat e saj bazë dhe pjesëmarrje frytdhënëse në shoqëri.
- Familjet në varfëri energjitike përballen me nivel të pamjaftueshëm të energjisë bazë (psh parehati ngrohtësie brenda), shpenzime energjie jo proporcionale që i shtyn në vendimarrje të padëshirueshme (psh dilemma 'ngrohur apo ngrenë'), ose qasje e pasigurtë në energji (dmth në varësi të furnizimit të paqëndrueshëm, të pasigurtë). Varfëria e energjisë rezulton në pabarazitë strukturore në shpërndarjen e të ardhurave dhe aksesin në strehimin cilësor, cmimin e pamjaftueshëm të energjisë dhe politikat e ndjeshme të mbështetjes së konsumatorit si dhe nevojat dhe praktikat e ndryshme të energjisë në shtëpi. Është një formë e vecantë e privimit material me një përmasë të qartë gjinore dhe ndikime të shprehura në shëndetin mendor dhe fizik.



Foto nga: DOOR



Fakte dhe shifra nga Varfëria Energjitike në Evropë



njerëz nuk mund t'i mbajnë shtëpitë ngrohtë në dimër



njerëz nuk ndihen rehat në shtëpi gjatë verës



njerëz hasin vonesa në pagimin e faturës së energjisë

Burimi: Observatori Evropian i Varfërisë Energjitike: energypoverty.eu



Njerëzit e prekur nga varfëria energjitike



Photo credit : DOOR

Njerëzit që preken më shumë nga varfëria energjitike janë :

- Të moshuarit
- Familjet me një prind
- Të papunët
- Studentët
- Punëtorët e varfër
- Gratë



Varfëria energjitike në Mesdhe

Zonat bregdetare të vendeve të mesdheut vuajnë nga çështje specifike që mund të çojnë në varfëri energjitike :

- Pjesa më e madhe e të ardhurave familjare shkon për faturën e energjisë;
- Tension në tregun e pasurisë së paluajtshme (për shkak të turizmit) ku familjet me të ardhura të ulta e kanë të vështirë të gjejnë banesa të përshtatshme që plotësojnë nevojat e tyre;
- Termoizolim të ulët të shtëpive dhe nivel i lartë i përkeqësuar i stokut të banesave;
- Verë e nxehtë dhe paret nga temperaturat e larta, me një ndjeshmëri ndaj ndryshimeve klimatike pasi valët e të nxehtëit po shpeshtohen dhe intensifikohen;
- Mungesa e sistemeve të para instaluar të ngrohjes qendrore ose me efektivitet të ulët dhe sisteme ngrohje jo të përshtatshme;
- Varësi e lartë nga format e shtrenjta të bazuara tek energjia elektrike për ngrohjen e banesave.



Pasojat e varfërisë energjitike

Varfëria energjitike sjell parehati nga të nxehtit dhe ndikon në **shëndet dhe mirëqenie** me:

- **Përkeqësim të kushteve të banesave**: ftohtë, myk, lagështi...;
- **Vështirësi ekonomike**: fatura të papërbalueshme dhe detyrime, zgjedhje ndërmjet ushqimit dhe ngrohjes e stresit të shtuar;
- **Vështirësi shoqërore**: izolim shoqëror, vetëvlerësim në rënie...;
- **Probleme shëndetësore**: sëmundje respiratore dhe kardiovaskulare si dhe gjendje gripi, ftohje, artriti dhe reumatizmale, por edhe probleme të shëndetit mendor.



Varfëria energjitike dhe çështjet gjinore

- Gratë dhe kryefamiljaret gra preken në mënyrë dispropocionale nga varfëria energjitike.
- Për shkak të ndarjes së punëve, gratë kanë tendencë të shpenzojnë më shumë kohë në shtëpi dhe ndaj janë më të ekspozuara ndaj varfërisë energjitike dhe pasojave të saj.
- Prindërit e vetëm janë një grup tjetër shumë i prekur – në BE, rreth 85% e prindërve të vetëm janë gra, mirëqenia e tyre preket rëndë nga ngarkesat financiare dhe psikosociale.



Përfitimet nga adresimi i varfërisë energjitike



Foto nga: DOOR

Adresimi i varfërisë energjitike mund të sjellë përfitime të shumfishta përfshirë:

- Më pak shpenzime nga qeveritë për shëndetin,
- Reduktim të ndotjes së ajrit,
- Komoditet dhe mirëqenie më të mirë,
- Përmirësim të buxhetit të familjes,
- Aktivizim të njerëzve,
- Familje të fuqizuara dhe të motivuara.



Objektivat e EmpowerMed



Photo credit : DOOR

Synimi i përgjithshëm i projektit **EmpowerMed** është të kontriboj në **zbutjen e varfërisë energjitike dhe përmirësimin e shëndetit** të njerëzve të prekur nga varfëria energjitike në vendet e Mesdheut, specifikisht tek gratë, përmes:

- zbatimit të zgjidhjeve praktike për të fuqizuar mbi **10,000** njerëz të prekur nga varfëria energjitike.
- vlerësimin të ndikimit të këtyre masave për të formuluar rekomandime dhe politika lokale, kombëtare dhe në nivel BE.
- promovimit të zgjidhjeve politike për të adresuar varfërinë energjitike në nivel vendor, kombëtar dhe BE tek të **220** vendimarrësit, **560** aktorët social, **100** kompanitë furnizuese, **180** ekspertët e shëndetit dhe **100** ekspertët e varfërisë energjitike.



Aktivitetet

Mobilizimi i aktorëve vendor

Ndërtimi i kapaciteteve të partnerëve dhe aktorëve kyç

Vizita në familje për energjinë

Mbledhje kolektive

Analizë dhe formulim rekomandimesh për të adresuar varfërinë energjitike

Advokim për zgjidhje gjinore dhe politike të varfërisë energjitike

Workshope «Bëje vetë»

Workshope për shëndetin



Zonat pilote

Masat praktike zbatohen në 6 zona pilot me një përjasje partneriteti të madh



Shqipëria
Kroacia
Franca
Italia
Sllovenia
Spanja



EmpowerMed në Slloveni

- **Zona pilot:** qytetet bregdetare të **Koper, Piran dhe Izola** - 86,000 banorë
 - Përfitues të rregullt të ndihmës sociale: 3%
 - Aktorët lokal: qendrat vendore për punë sociale, Caritas dhe Kryqi i Kuq, shoqatat e pensionistëve, grupet vendore të shëndetit, grupet që lidhin komunitetet vendore
 - Sfondi: Qeveria Sllovene po zbaton një program kombëtar për vizita në familje në varfëri energjitike dhe që përballen me interes të pamjaftueshëm për vizita
- **Aktivitetet në kuadër të EmpowerMed:**
 - Vizita në familje dhe instalim të pajisjeve për kursim energjie
 - Mbledhje kolektive
 - Workshope shëndeti
 - Workshope të tipit "Bëje vetë"
 - Mbështetje për familjet për të aplikuar në skema mbështetje për masa të efijencës së energjisë, të ofruara nga qeveria.



EmpowerMed në Spanjë

- **Zona pilot: Zona Metropolitane e Barcelonës** – 5.5 milion banorë
 - 24 % e popullsisë në rrezik varfërie energjitike ose përjashtimi social. Në qytetin e Barcelonës, 55% e popullsisë në risk janë gra. Më shumë se 100,000 familje janë në kushtet e varfërisë energjitike.
 - Aktorët lokal: Pikat e Këshillave për Këshillim Energjie në Barcelonë dhe zyrat përkatëse ose shërbimet sociale në bashkitë e tjera të zonës metropolitane dhe furnizuesit aktual të energjisë dhe gazit
 - Sfondi: familjet vulnerable janë në rrezik të shkëputjes nga rrjeti i energjisë dhe gazit për shkak të situatës së pasigurt. Në më të shumtën e këtyre familjeve ka gra dhe fëmijë.
- **Aktivitetet në kuadër të EmpowerMed:**
 - Organizimi i mbledhjeve kolektive për energjinë dhe çështje të shëndetit për të fuqizuar familjet në rrezik (ose që vuajnë) nga shkëputja nga rrjeti i energjisë dhe të tjera.
 - Workshope energjie “Bëje vetë” sesi të lexojnë dhe të kuptojnë faturat e energjisë, dhe të japin këshilla sesi të aksesojnë fondet për eficiencë energjie, p.sh, fonde për rindërtimin e shtëpive.
 - Sesione këshillimore për familjet e prekura për të adresuar drejt komponentin emocional dhe të shëndetit mendor të lidhur me varfërinë energjitike.



EmpowerMed në Kroaci

- **Zona pilot: Zadar** – 75,000 banorë
 - Shtrihet në bregdetin Adriatik, qyteti i pestë për nga madhësia
 - Rreth 5-6 % e popullsisë përfiton mbështetje sociale (paga minimale e garantuar, mbështetje e njëhershme, mbështetje paaftësie ose banese) dhe 2% përfitojnë nga mbështetja për pagesën e karburantit në dimër.
 - Sfondi: 2 projekte të mëparshme (Fiesta dhe REACH) theksuan nevojën për më shumë vëmendje tek varfëria energjitike në zonat bregdetare me klimë mesdhetare.
 - Tradicionalisht familjet janë së shumti të drejtuara nga gratë, që kujdesen për faturat, por kanë mungesë njohurish bazë në energji dhe të masave për eficiencë energjie.
 - Aktorët lokal: përfaqësuesit vendor, aktorët shoqëror, ekspertë të shëndetit dhe OJF lokale.
- **Aktivitete në kuadër të EmpowerMed:**
 - Vizita energjie dhe instalim të aparaturave kursimi energjie kryesisht për familjet që drejtohen nga gratë (mama të vetme, mama të familjeve me shumë anëtarë, pensionistë, gra të veja) por edhe familje me vështirësi në energji;
 - Mbledhje kolektive mbi shëndetin dhe energjinë, dhe takime me familje mbi teknikat “bëje vetë”;



EmpowerMed në Itali

- **Zona Pilot: Bashkia e Padovës** - 200,000 banorë
 - Qendër e rëndësishme universitare: rreth 60,000 studentë
 - 8-9% e familjeve në Itali me fatura të prapambetura energjie. Në Padova, 64% e mbështetjes financiare për familjet në nevojë shkon për pagesën e energjisë (*Diocese Padova*)
 - Popullsia më vulnerabël janë familjet me një prind dhe të moshuarit, që jetojnë në banesa me efikasitet energjie të ulët duke rritur efektin e varfërisë energjitike
 - Aktorët lokal: Departamenti i mjedisit në qytetin e Padovës, shërbimet sociale, Universiteti i Padovës, Observatori Italian i Varfërisë Energjitike, shoqata e studenteve të energjisë LEDS, komunitetet fetare, OJF lokale, shkollat.
-
- **Aktivite në kuadër të EmpowerMed:**
 - Vizita energjie për familjet me të ardhura të ulta dhe të moshuarit
 - Takime kolektive në shkolla për energjinë dhe shëndetin për të adresuar familjet me 1 prind;
 - Takime kolektive me komunitetet fetare për energjinë dhe shëndetin



EmpowerMed në Francë

- **Zona pilot: Zona Metropolitane e Provincës së Marsejës** – 1.8 million banorë
 - 9% e familjeve shpenzojnë mbi 15% të të ardhurave për energji. Niveli i varfërsisë është më shumë se 25% në Marsejë, ku një distrikt i kalon 50%.
 - Stoku i mundshëm i banesave të padobishme vlerësohet në 40,000, duke përfaqësuar rreth 100,000 vetë.
 - Aktorët lokal: Shoqatat e strehimit social, qendrat sociale, shoqatat e qytetarëve vendor (përfshirë organizatat e grave), organizatat humanitare, ndërmarrjet e integritit profesional për zbatimin e masave të energjisë
- **Aktivitete në kuadër të EmpowerMed:**
 - Trajnimi i këshilltarëve të energjisë dhe zhvillimi i vizitave në familjet me të ardhura të ulta të identifikuara nga partnerët lokal që janë në kontakt të vazhdueshëm me qytetarët
 - Workshope kolektive për çështje të energjisë dhe shëndetit për familjet vulnerabël
 - Përqasja gjinore do të hulumtohet për të kuptuar më mirë vëzhgimet informale të deritanishme (më shumë gra në nevojë, grate mirëpritene më mire si këshilluese energjie krahasuar me burrat...) dhe të adoptohen zgjidhje më të mira
 - Fokusi në sfida mesdhetare: do të hulumtohen masat më të pranueshme të rehatisë nga temperaturat gjatë verës



EmpowerMed në Shqipëri

- **Zona Pilot: Bashkia Vlorë** - 117,000 banorë
 - Bashkia e tretë më e madhe në Shqipëri përgjatë bregut
 - Varfëria energjitike: familjet me të ardhura të ulta shpenzojnë 35% të të ardhurave të tyre për faturën e energjisë, dhe shtëpitë e grupeve vulnerabel shpesh janë të ftohta dhe me lagështi në dimër për shkak të vështirësisë për ta ngrohur sa duhet shtëpinë, ndaj risqet në shëndet janë të larta.
 - Aktorët lokal: Bashkia dhe Qarku i Vlorës, Universiteti i Vlorës, OJF lokale, ekspertë shëndeti dhe shkolla profesionale.
- **Aktivitete në kuadër të EmpowerMed:**
 - Vizita në familje për energjinë së bashku me trajnimin e audituesve të energjisë me student të universitetit dhe shkollave profesionale
 - Workshope të tipit "Bëje vetë" mbi instalimin e paneleve fotovoltaike
 - Workshope mbi energjinë dhe shëndetin



Rezultatet dhe ndikimi i pritshëm i projektit EmpowerMed



Foto nga: GERES

- **10,200** njerëz të fuqizuar për të adresuar varfërinë energjitike.
- Përfshirja e më se **1000** aktorëve vendor në **6** zona pilot
- Së paku **60%** e grave pjesëmarrëse
- Kontributi në politika: **8** politika apo masa të rekomanduara
- Energji primare e kursyer: **6.5 GWh/vit**
- Reduktimi i emetimeve të CO₂: **1,600 t CO₂/vit**
- Investime në energji të qëndrueshme: **160,000 €**
Kursime në ekonomi: **780,000 €**



Partnerët e EmpowerMed

The logo for Focus consists of a green rounded rectangle with the word "focus" in white lowercase letters. Below it, in smaller white text, is "društvo za sonaraven razvoj".

focus

društvo za sonaraven razvoj

Focus Organizata për Zhvillim të Qëndrueshëm (Focus drustvo za sonaraven razvoj, Slovenia) është e pavarur, jo qeveritare, jo përfituese dhe jo politike. Focus punon në fushat e: ndryshimeve klimatike, energjisë, transportit të qëndrueshëm, përgjegjshmërisë globale, konsumit etik dhe rritjes.

Focus koordinon projektin EmpowerMed

DOOR (Društvo za oblikovanje održivog razvoja, Kroaci) është një organizatë shoqërisë civile eksperte e fokusuar në promovimin e zhvillimit të energjisë së qëndrueshme, themeluar në 2003. DOOR ka zbatuar me sukses mbi 100 projekte me objektiva nga mitigimi i ndryshimeve klimatike, nxitja e pjesëmarrjes qytetare në politik-bërjen e energjisë së qëndrueshme, përmirësimin e edukimit mbi burimet e energjisë së rinovueshme dhe zbutjen e varfërisë.



DOOR

The logo for SOGESCA features a blue circular icon with a white arrow pointing clockwise, followed by the word "SOGESCA" in a bold, blue, sans-serif font.

SOGESCA

SOGESCA (Itali) është një kompani konsulente dhe inxhinierësh aktive nga viti 1986, specializuar në mjedis, kujdesin në punë dhe çështje të eficiencës së energjisë. SOGESCA ofron shërbime konsulente me ekspertizë të lartë kompanive dhe autoriteteve publike në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Ofron mbështetje profesionale të lartë në mjedis, auditim energjie dhe sigurie, sisteme menaxhimi, hartim dhe përditësim, shërbime licencimi, due diligence, projekte efijence energjie, planifikim, menaxhim të integruar të mbetjeve, ujrave, energji, etj.



Partnerët e EmpowerMed



Universitat Autònoma de Barcelona (Spanjë). Instituti i Mjedisit, Shkencës dhe Energjisë në Universitetin Autonom të Barcelonës (ICTA-UAB) është një qendër multidisiplinare që promovon kërkimin akademik dhe arsimin pas universitar në shkencat mjedisore. Ai synon të përmirësoj të kuptuarin tonë ndaj ndryshimeve mjedisore globale, dhe natyrën e shkaktarët e problemeve mjedisore. Për më tepër, studion politikat, strategjitë dhe teknologjitë për të nxitur kalimin drejt një ekonomie të qëndrueshme.

Institut de Recerca en Energia de Catalunya (Spanjë) kontribon në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë dhe rritjes së konkurrencës së korporatave përmes: Inovacionit dhe zhvillimit të produkteve me teknologji të re; kërkimeve afatmesëm dhe afatgjatë; dhe zhvillimit të njohurive teknologjike dhe shkencore në fushën e energjisë.



Krijuar në 1976, Geres (France) është një OJF zhvillimore që punon në Evropë, Afrikë dhe Azi për të përmirësuar kushtet e jetesës dhe të luftojë ndaj ndryshimeve klimatike dhe ndikimit të tij. Në interes të ndryshimit ambicioz shoqëror, nxit zhvillimin dhe mbledhjen e zgjidhjeve inovative, me bazë vendore, mbështet politikat e klimës dhe energjisë territoriale dhe mobilizon të gjithë palët e interesuara rreth Solidaritetit të Klimës, duke i nxitur ata të ndërmarrin veprime dhe të qëndrojnë së bashku me grupet më vulnerabel.



Partnerët e EmpowerMed



The Catalan Association of Engineering Without Borders (Spanjë) është një shoqatë për zhvillim e bashkëpunim. Përbëhet nga profesionistë, mësues dhe studentë, shumica vullnetarë, që punojnë për të garantuar akses universal në shërbimet bazë, që shoqëron ndryshimin shoqëror dhe forcon popullatën, duke respektuar gjithmonë karakteristikat teknike dhe kulturore. Punon për të ndërtuar një shoqëri globale të drejtë dhe të bashkuar dhe të vendosë teknologjinë në shërbim të zhvillimit njerëzor.

WOMEN IN EUROPE FOR A COMMON FUTURE (Gjermani) është një rrjet organizatash jo përfituese dedikuar drejtësisë gjinore dhe planetit të shëndetshëm për të gjithë, përbëhet mbi 150 organizata grash dhe të shoqërisë civile që zbatojnë projekte në 50 vende. Ajo punon në barazinë gjinore transformuese dhe të drejtat e njeriut në ndërlidhje me të drejtën klimaterike, energjinë e qëndrueshme & kimikatet, reduktimin e mbetjeve toksike, ujin e sigurt & higjenë për të gjithë.



Milieucontact Shqipëri ka 20 vite eksperiencë me organizatat e shoqërisë civile në mjedis, natyrë dhe zhvillim të qëndrueshëm si dhe me autoritetet që meren me këto çështje në Shqipëri. Tre elemente janë shtyllat e punës sonë: ndërtimi i kapaciteteve, përfshirja e qytetarëve dhe zgjidhja e problemeve mjedisore. Stimulon dhe mbështet përfshirjen dhe fuqizimin e qytetarëve, zhvillon procese pjesëmarrëse dhe vendimarrëse. Ajo lidh këto procese me zgjidhje konkrete për problemet mjedisore.



FALEMINDERIT

Per te gjetur partnerin tuaj lokal, ju lutem vizitoni faqen tone:

www.empowermed.eu



@Empowermed_eu



@Empowermed.eu



EmpowerMed



EmpowerMed

www.empowermed.eu



Ky projekt financohet nga Programi i Kërkimit dhe Inovacionit Horizon 2020 të Bashkimit Evropian, kontrata Nr. 847052. Përgjegjësia për përmbajtjen e këtij dokumenti është vetëm e autorëve. Ajo jo domosdoshmërisht pasqyron mendimin e Bashkimit Evropian. As EASME dhe as Komisioni Evropian nuk janë përgjegjës për përdorimin që mund ti bëhet informacionit..

